

Të nderuar anëtarë të trupës gjyqëse,

në përfundim të shqyrtimit të këtij ankimi, të paraqitur nga ana e Komisionerit Publik ndaj vendimit nr.02, datë 16.02.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dua të nënvizoj se edhe pas debatit gjyqësor të zhvilluar, çështjet ligjore që përbëjnë shkakun e ankimit, mbeten për të marrë përgjigje nëpërmjet vendimit gjyqësor të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pasi 2 aktet e paraqitura nga mbrojtja e subjektit në seancën e kaluar nuk ndryshojnë asgjë në situatën ligjore të çështjes konkrete.

A gëzon statusin e magjistratit z Adriatik Llalla?

Nuk dëgjova nga parashtrimet e avokatit që ta mohojë se z Adriatik Llalla e gëzon këtë status ligjor.

Z Adriatik Llalla është magjistrat.

Është magjistrat sepse kështu e sanksionon neni 148/a, pika 5, neni 179, pika 10 e Kushtetutës dhe neni 2, gërma "gj", neni 164, pika 1, gërma "b" e ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", përsa kohë ka qenë në



detyrën e Prokurorit të Përgjithshëm kur hynë në fuqi ndryshimet kushtetuese dhe paketa e ligjeve të reformës në drejtësi.

Z Adriatik Llalla është magjistrat, për shkak sepse është emëruar prokuror i Republikës me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.2298, datë 15.01.1999.

Është e vërtetë se në vitin 2008 z Adriatik Llalla i ka paraqitur dorëheqjen Prokurorit të Përgjithshëm nga detyra e prokurorit të Prokurorisë Tiranë.

Po aq e vërtetë është që nuk ka asnjë Dekret të Presidentit të Republikës që të lirojë nga detyra e prokurorit z Adriatik Llalla.

Në parashtrimet e tij, avokati i referohet një urdhri të Prokurorit të Përgjithshëm që vendos lirimin e prokurorit Adriatik Llalla nga detyra, të datës 30 tetor 2008.

Ky urdhër nuk gjen mbështetje në Kushtetutë, referuar përmbajtjes së atëkohshme të dispozitës së neneve 148 – 149.

Një vendim unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.3/2003, teksa bën interpretimin gjyqësor të dispozitave që lidhen



me statusin e prokurorëve e thotë qartë: “...është në diskrecionin e shtetit, të mishëruar në Dekretin e Presidentit jo vetëm krijimi, por edhe ndryshimi apo shuarja e marrëdhënieve të shërbimit publik...Në këtë kategori funksionarësh të rëndësishëm të shtetit janë përfshirë edhe prokurorët e të gjitha niveleve. Kjo rezulton prej neneve 148, 149 të Kushtetutës dhe dispozitave të ligjit organik për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë. “

Ndryshimet e ligjit organik të sistemit të prokurorisë të vitit 2008 nuk kanë sjell asgjë të re në këtë situatë kokëfortë ligjore, pavarësisht nga sa u pretendua nga avokati në parashkrimin e tij.

Në rastin e z Adriatik Llalla jemi përballë një magjistrati, si për shkak të funksionit të tij si ish Prokuror i Përgjithshëm, ashtu dhe për shkak të statusit të prokurorit të thjeshtë, që ai nuk e ka humbur asnjëherë, pasi procedura e parashikuar në Kushtetutë nuk është ndjekur.

Çfarë po kërkon nëpërmjet këtij ankimi Komisioneri Publik?

Po kërkon zbatimin e procedurës për paraqitjen, administrimin, deklarin dhe rregullimin e pasojave të një akti juridik, që është dorëheqja e magjistratit.



Është e vërtetë. Dorëheqja është akti vullneti i pakushtëzuar. Por ky vullnet në qoftë se nuk shprehet nëpërmjet formës dhe procedurës ligjore, është nul, nuk mund të prodhojë pasoja juridike.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit mjaftonte t' i referohej ligjit nr.96/2016, neneve 64, 65 dhe 160 dhe do të arrinte në konkluzionin se nuk ka patur kompetencë ligjore të zbatonte nenin G të Aneksit të Kushtetutës për z Adriatik Llalla.

Dorëheqja e magjistratit është një institut ligjor, që gjen rregullim të posaçëm në ligjin nr.96/2016.

Pa u materializuar dorëheqja në formën dhe procedurën e parashikuar në ligj, nuk mundet ajo të prodhojë asnjë efekt juridik, qoftë ky dhe ndërprerja e procedurave të rivlerësimit kalimtar.

Është më shumë se interesante të lexosh procesverbalet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë të datës 10.02.2017. Pikërisht në këtë mbledhje është marrë vendimi për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për dy magjistratë/gjyqtarë, të cilët janë dorëhequr duke kërkuar mos t' i nënshtrohen procedurave të vettingut.



Në këtë mbledhje trajtohen pikërisht ato elementë, që do të duhet të merren në shqyrtim në rastet e paraqitjes së dorëheqjes së magjistratit:

A është nënshkruar dorëheqja nga vetë magjistrati, kur kjo dorëheqje është paraqitur me postë?

A është shprehur i lirë vullneti i magjistratit, kur kjo dorëheqje është paraqitur me postë?

Ju ftoj vetëm të mendoni për një moment, çfarë mund të ndodhë në rast se një magjistrat, cilido qoftë ai, çfarëdo emri të ketë, që supozohet që ka dhënë dorëheqjen, ditën që mbaron mandati i organeve të rivlerësimit, të ngrihet e të pretendojë se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka ndërprerë procesin e rivlerësimit mbi një akt dorëheqje të dërguar me postë në emër të tij, por që nuk është nënshkruar nga vetë magjistrati.

Duke qenë se magjistrati nuk ka dhënë dorëheqjen, pasi asnjë institucion nuk verifikoi në qoftë se ai vetë nënshkroi aktin e dorëheqjes, ai nuk mund të udhërohet të qëndrojë jashtë organeve të sistemit të drejtësisë për 15 vjet me radhë.

Ditën që mbaron mandati i institucioneve të rivlerësimit, gati ekzakt katër vite më pas nga dita e sotme, magjistrati ka të gjithë të drejtën të kërkojë rikthimin në sistem, duke mos e kaluar kurrë kështu procesin e rivlerësimit.

Vetëm organi i ngarkuar me ligj, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, e deri në ngritjen e tyre Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Prokurori i Përgjithshëm mund të verifikojnë këto elementë thelbësore të formës së shprehjes së vullnetit të magjistratit. Asnjë organ tjetër nuk ka kompetencë ta bëjë këtë, aq më pak Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

Interesi publik e kërkon që një magjistrat që jep dorëheqjen për të mos iu nënshtruar procesit të rivlerësimit, të ndjekë procedurën ligjore.

Vetëm zbatimi i kësaj procedure ligjore do të garantojë përmbushjen e ndalimit të parashikuar nga paragrafi i dytë i nenit G të Aneksit të Kushtetutës, që urdhëron se ky magjistrat që dorëhiqet për mos iu nënshtruar vettingut, për 15 vite nuk mund të jetë më pjesë e institucioneve të sistemit të drejtësisë.

Në ankimin dhe parashtresën e prezantuar në seancën gjyqësore paraardhëse, Komisioneri Publik me detaje ka trajtuar shkaqet e ankimi dhe kërkimet e tij përpara Kolegjit të Apelimit.

Përsa kohë, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka marrë një vendim, në kushtet kur dorëheqja e subjektit të rivlerësimit z Adriatik Llalla nuk mund të prodhonte efekte juridike, Komisioni nuk ka patur kompetencën ligjore të vendoste për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për këtë subjekt.

Duke i qëndruar dhe shkaqeve të tjera të parashtruara në ankim, i kërkojmë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të shprehet dhe në lidhje me procedurën dhe organin kompetent që disponon për ndalimin e parashikuar nga paragrafi i dytë i nenit G të Kushtetutës, si dhe procedurat për zbatimin e pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.84/2016.

Përfundimisht, në referencë të gërmës "c" të pikës 1 të nenit 66 të ligjit nr.84/2016 kërkojmë:

Prishjen e vendimit nr.02, datë 16.02.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin z Adriatik Llalla.



Ju faleminderit,

KOMISIONERI PUBLIK

Florian Ballhysa
Florian BALLHYSA
06/06/2018

